

*Seminari i Fushës Frojdiane në Shqipëri
Rrethi Lakanian Shqiptar
Njësia për Fëmijën & Familjen NYJELAKIM*

*Seminari psikanalitik 2019-2020
Fëmija dhe simptomat e tij
Dr. Daniel Roy*

Symptoma : një përgjigje e subjektit

*5 Tetor 2019 9h00-17h30
Kryqi Kuq Shqiptar
Rruga 'Pjetër Budi', Tiranë*



ASSOCIATION DE LA FONDATION DU CHAMP FREUDIEN

74, rue d'Assas - 75 006 Paris

Tél : 01 45 48 56 72 – Fax : 01 45 48 79 38

SEMINARI I FUSHES FROJDIANE NE SHQIPERI

Paraqitje e përgjithshme

Seminari do të mbahet nga lektori i Fushës Frojdiane, **Dr. Daniel Roy** anëtar i NLS
(*New Lacanian School*) dhe i Shoqatës Botërore të Psikanalizës (A.M.P.)

Sekretar i Përgjithshëm i *Institutit Psikanalitik të Fëmijës*.

Ky cikël seminaresh organizohet nga Sekretariati i Fushës Frojdiane për Europën
Lindore.

Seminari klinik 2019-2020

« Fëmija dhe simptomat e tij »

Sesioni i parë do të zhvillohet në **5 Tetor 2019**

Nga **Daniel Roy**, psikanalist, psikiatër në Francë

Sesioni i dytë do të zhvillohet në **7 Mars 2020**

Nga **Gian Francesco Arzente**, psikanalist në Torino

Sesioni i tretë do të zhvillohet në **6 qershor**

Nga **Guy Poblome**, psikanalist në Belgjikë

Regjistrimet kryhen në adresën elektronike seminaret_e_psikanalizes@nyjelakim.net

Donacioni për seminarin – 2000 lekë.

Për më shumë informacione vizitoni faqen tonë zyrtare www.nyjelakim.net

Ky cikël seminaresh është i akredituar nga Q.K.E.V.

Simptoma : një përgjigje e subjektit

Sigmund Frojdi, ishte i vëmendshëm ndaj lojës së nipit të tij dhe vë re se kur nëna del nga dhoma ku e ka vendosur, në shtratin e tij të vogël, djali merr një bobinë, një prej lodrave të fëmijës, ku është lidhur një fije spangoje. Djali e hedh bobinën jashtë shtratit të tij duke vokalizuar « o-o » pastaj e tërheq nga vetja duke thënë « a-a ». Frojdi dallon në këto dy vokalizime fjalët *fort* (« tutje ») dhe *da* (« aty ») ashtu siç ai i kishte për zakon t'i përdorte. Ky është shembulli i një përgjigjes që i jep një subjekt një ngjarjeje të cilën nuk e ka në kontroll. Kjo është një përgjigje e « subjektit » sepse fëmija thërret në ndihmë njëkohësisht elementë të gjuhës por dhe të « dialektikës » së një objekti, për të trajtuar një ndodhi të realitetit : ikjen e nënës dhe derën që mbyllet, duke e lënë fëmijën vetëm, me mungesën e nënës së tij. J. Lacan-i do ti rikthehet disa herë këtij episodi dhe ne do të marrim në shqyrtim komentet e tij.

Një tjetër « moment frojdian » me një fëmijë më të madh në moshë: makthi i Hansit të vogël dhe shfaqja e fobisë së tij të kuajve. Ai i tregon nënës ëndrrën e tij.

: ajo kishte « ikur » dhe « ai nuk kishte më një mama me të cilën do të përqafohej ». Diçka u fut ndërmjet tij dhe nënës së tij duke shkaktuar ndërprerjen e « lojrave të rreme » ndërmjet tij dhe nënës, sipas termave të Lacan-it. Kjo pikërisht është dita që shfaqet fobia e tij ndaj kuajve gjatë shëtitjes së përditshme të zakonshme që ai bënte me nënën e tij. Ne do të tregojmë se si kjo simptomë sipas po të njëjtës logjikë, përbën një « përgjigje të subjektit » në një nga momentet ku fëmija shfaq më tepër druajtje.

Këto dy fakte klinike do të jenë guida jonë për të vënë në dukje risinë radikale që zbulon psikanaliza, çdo herë që një qenie folëse, e vogël ose e rritur, hyn në kuadrin që përcakton një psikanalist : një nga ku fjala respektohet veçmas. Kjo risi është e mëposhtmja : simptoma nuk është një aranzhim i keq që duhet zhdukur, simptoma, në veçantinë e saj përmban në vetvete elementët më të çmuar për një subjekt, d.m.th. përgjigja e tij ndaj ngjarjeve të cilat nuk i zgjedh dhe ndaj pritshmërive të partnerëve të tij.

Sigurisht, simptoma është një përgjigje që bezdis, fëmijën dhe rrethin e tij familjar, që sjell shqetësim dhe angështi dhe këto aspekte nuk do të neglizhohen nga prakticioni, por simptoma është më së pari një modalitet trajtimi i diçkaje që është me tepri dhe që i është bashkëngjitur trupit të vet dhe/ose përfytyrimeve të veta. Si e tillë ne i kushtojmë simptomës një vëmendje dhe një konsideratë të veçantë.

Dr. Daniel Roy

Bibliografia

- S. Freud, « Au-delà du principe de plaisir, in *Essais de psychanalyse*, Paris, Payot, pp. 51-55
- J. Lacan: *Le Seminaire, Livre XI*, Paris, Seuil, pp. 60-61
- J. Lacan, *Les Écrits*, Paris, Seuil, pp. 318-19

PROGRAMI

Kumtesat

08h30 - 08h50 : Regjistrimi i pjesëmarrësve

08h50 - 09h00 : Përshëndetje e pjesëmarrësve nga **Jolka Nathanaili- Penotet**,
Presidente e Rrethit Lakanian Shqiptar

09h00 - 10h00 : Kumtesa “*Simptoma një përgjigje e subjektit. Si t’i qasemi ankthit dhe vuajtjes psikike të fëmijës?*” nga **Dr. Daniel Roy**

10h00 - 10h30 : Pyetje dhe diskutime nga pjesëmarrësit

10h30 - 11h00 : *Vijimi i kumtesës nga Dr. Daniel Roy “...Si t’i orientojmë prindërit dhe profesionistët kundrej diagnozave: çrregullimet e vëmendjes, të hiperaktivitetit, çrregullimet pervazive të zhvillimit, disleksitë, dispraksitë etj.?”*

Prezantimet Klinike

12h00 - 12h30 : Prezantim rasti klinik “*Nga dega në degë & nga një gjuhë në tjetrën; çfarë e mban subjektin e thënies?*” nga **Jolka Penotet**, *Njësia për Fëmijën & Familjen NYJELAKIM*

12h30 - 13h00 : Pyetje dhe diskutime nga pjesëmarrësit

13h00 - 14h00 : *Pushim*

14h00 - 14h30 : Prezantim klinik “*Iriqi*” nga **Sonilda Barjamaj**, *Qendra Sociale Multidisiplinare*

14h30 - 15h00 : *Pyetje dhe diskutime*

15h00 - 15h15 : *Pushim*

Analizë e Praktikave dhe Ndërhyrjeve në Institucionet për fëmijë

15h15 - 15h25 : Prezantim rasti “*Unë jam më art se ti*”, **Matilda Odobashi**, atelie ergoterapie, *Njësia për Fëmijën & Familjen NYJELAKIM*

15h25 - 15h45 : Pyetje dhe diskutime

15h45 - 16h00 : Puna me një fëmijë autik “*Nga Zh-ja tek A-ja*”, **Inva Mamica**, *Njësia për Fëmijën & Familjen NYJELAKIM*

16h00 - 17h00 : Pyetje dhe diskutime nga pjesëmarrësit

17h00 - 17h30 : *Përfundime dhe perspektiva kliniko-teorike nga dr. Daniel Roy*